



NATIONAL
YOUTH
CONGRESS

FRIEDRICH
EBERT
STIFTUNG

BASHKIA
PËRMET

MASTER PLANI I PUNËSIMIT

FALENDERIME

Master Plani i Punësimit në Bashkinë Përmet është një dokument strategjik politikash dhe është krijuar në kuadër të projektit “Jeto Qytetin Tënd-Politikat Rinore në Nivel Lokal” me qëllim përmirësimin e politikave të punësimit dhe gjendjes aktuale të punësimit të rinjve në Bashkinë Përmet. E njëjta iniciativë është ndërmarrë edhe në 11 bashki të tjera të Republikës së Shqipërisë.

Falenderime të veçanta i shkojnë Fondacionit Friedrich Ebert Stiftung në Tiranë i cili ka mbështetur Kongresin Rinor Kombëtar dhe programin e dedikuar politikave rinore në nivel lokal prej tre vitesh.

Falenderime i shkojnë gjithashtu përfaqësuesve të administratës publike që morrën pjesë gjatë takimeve me fokus grupet përgjatë gjithë hartimit të Master Planit. Pa bashkëpunimin e tyre dhe ndarjen e informacioneve ky master plan nuk do të ishte i njëjti.

Falenderime shkojnë për bashkëautorin, Dorjan Merja, koordinator lokal i qytetit të Përmetit, përfaqësues i organizatës “Cesvi Albania”. Shpreh mirënjohje gjithashtu ndaj ekspertëve të cilët asistuan 12 koordinatorët lokalë në analizimin e situatës aktuale dhe evidentimin e problematikave dhe sygjerimeve të mundshme për përmirësimin e situatës. Faleminderime kolegëve koordinatorë të cilët ndanë eksperiencat dhe kontributin e tyre gjatë gjithë këtij procesi.

Mbi të gjitha falenderime të përzemërta i shkojnë të gjithë organizatave rinore lokale pjesë apo jo e Kongresit Rinor Kombëtar, pjesëmarrësve, të rinjve, aktivistëve, studenteve dhe qytetarëve të cilët morën pjesë dhe dhanë kontributin e tyre gjatë fazës së konceptimit dhe dizenjimit të këtij dokumenti.

Pikëpamjet e paraqitura në këtë dokument janë të Kongresit Rinor Kombëtar dhe jo domosdoshmërisht paraqesin pikëpamjet e Fondacionit Friedrich Ebert Stiftung.

TABELA E PËRMBAJTJES:

FALENDERIME

I.	PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE	3
II.	TË RINJTË DHE TREGU I PUNËS NË KORÇË	4
III.	OBJEKTIVAT	5
IV.	PARIMET UDHËHEQËSE	6
V.	ANEKSET	7
	ANEKSI I : ORIENTIMI DREJTË TREGUT TË PUNËS	8
	ANEKSI II : EDUKIMI DHE TRAJNIMI	10
	ANEKSI III : MUNDËSITË E PUNËSIMIT	13
	ANEKSI IV : AKSES I BARABARTË NË PUNËSIM	15
	ANEKSI V : SIPËRMARRJA	16
	ANEKSI VI : PËRMIRËSIMI I KUADRIT INSTITUCIONAL	18

I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Shqipëria është një nga vendet me popullësinë më të re në rajon ku të rinjtë nën moshën 30 vjeç përfaqësojnë 45.6% të popullësisë.

Në Bashkinë Përmet të rinjtë përbëjnë 23% të gjithë popullësisë duke e renditur si Bashkinë Përmet si një nga bashkitë me përqendrimin më të ulët të të rinjve në vend. Ndërkohë ky përqendrim në njësitë administrative rurale shkon në 16%.

Ky rezultat është i ndikuar jo vetëm nga mungesa e vendeve të punës apo puna sezonale por edhe nga emigracione dhe migrimi i të rinjve drejt qendrave dhe qyteteve më të mëdha ku mundësitë e punësimit janë të larta nga numri i lartë i bizneseve si dhe standarti i jetesës është më i lartë. Për këto arsye kjo grupmoshë kërkon një trajtim të veçantë dhe duhet të merret në konsideratë të vazhdueshme në hartimin e dokumentave strategjikë pasi ata përbëjnë forcën më të lartë punëtore në vend dhe janë komponentë kryesorë për të ardhmen gjithashtu dhe zhvillimin e qytetit dhe vendit.

Ky masterplan vjen si rezultat i përpjekjeve të vazhdueshme të Kongresit Rinor Kombëtar për të influencuar politikën rinore në nivel vendor dhe qendror me qëllim fuqizimin e të rinjve në 12 qarqet e vendit. Konkretisht në vitin 2017 Kongresi Rinor Kombëtar së bashku me institucionet publike dhe organizatat e saj partnere hartuan Planet Lokale Vendore, dokumente me rëndësi të veçantë për zhvillimin strategjik të të rinjve në 12 qarqet e Shqipërisë.

Në kuadër të projektit “Planet Lokale të Veprimit për Rininë - Jeto Qytetin Tënd” kemi zhvilluar takime dhe diskutime me grupime të të rinjve dhe organizatave rinore në 12 qarqet për të identifikuar problematikat dhe zgjidhjet e mundshme që prekin grupmoshën 15-29 vjeç.

Punësimi rinor mbetet një problem madhor në rang kombëtar i cili kërkon ndërhyrje të menjëhershme nga organizatat rinore në bashkëpunim me autoritete lokale dhe komunitetin e biznesit. Për këtë qëllim ne kemi hartuar Masterplanin për Punësimin e të Rinjve në bashkitë përkatëse.

Ky masterplan i dedikohet vetëm Bashkisë Përmet dhe ka si qëllim paraqitjen e situatës aktuale të punësimit të të rinjve në këtë bashki si dhe hartimin e objektivave strategjikë shoqëruar me rekomandimet përkatëse.

Ky dokument është i ndarë në pesë pjesë kryesore dhe është në vijueshmëri me dokumentat në nivel lokal, kombëtar dhe ndërkombëtar.

II. TË RINJTË DHE TREGU I PUNËS NË KORCË

Në nivel kombëtar çështja e punësimit është një nga pesë prioritet e kyçe të qeverisë por edhe në nivel lokal kjo çështje ka marrë një fokus të veçantë.

Kjo pasqyrohet edhe në dokumentet strategjike të hartuara në nivel qendror dhe vendos siç janë: Programi i Qeverisë 2017-2021; strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim 2014-2020, Strategjia për Punësim dhe Aftësi 2013-2020; Plani Kombëtar i Veprimit për Rininë, Strategjia e Mbrojtjes Sociale 2015-2020, Plani Kombëtar Veprimi 2010-2015.

Në nivel lokal paraqitet në dokumentat si:

Plani vendor i kujdesit social në Bashkinë Përmet, Menaxhimi i integruar i zhvillimit ekonomik të luginës së Vjosës, Strategjia Rajonale e Zhvillimit të Qarkut Gjirokastrë, etj.

Për të arritur një mirë-menaxhim të burimeve natyrore, financiare dhe kapitalit njerëzor në nivel kombëtar dhe lokal është e nevojshme të bëhet një analizë e mirëfilltë dhe e mirë detajuar e tregut të punës për të matur atë se çfarë kërkohet nga punëdhënësi dhe punëmarrësi në vendin e punës për të dalë me përfundime dhe rekomandime konkrete. Ajo çka duhet të theksohet është fakti se kjo analizë mungon çka e bën jo të qartë për aktorët që punojnë se ku duhet ti prioritetizojnë fondet dhe veprimet e tyre. Mbivendosja e punës, ripërsëritja dhe kosto janë problematika që vijnë pikërisht nga kjo mungesë.

Përsa i përket punësimit, Bashkia Përmet ka hartuar një sërë politikash ekonomike për tu ardhur në ndihmë të rinjve dhe grupeve të marginalizuara. Aktualisht janë zhvilluar një sërë politikash dhe programesh pilot në bashkëpunim me organizata të tjera dhe donatorë të ndryshëm si: mbështetje me grante për individë dhe organizata për start-up dhe projekte në fushën ngritjes së kapaciteteve, mbrojtja e mjedisit, vlerësimi i traditës dhe kulturës, promovim i produkteve tradicionale dhe destinacioneve turistike, mbështetje e bizneseve të reja, mbështetje në teknologji dhe përmirësim të kushteve higjieno-sanitare të bizneseve, etj.

Lidhur ngushtë me punësimin lidhet dhe çështja e aftësisë së cilës synon krijimin e një force punëtore të kualifikuar dhe në përputhje me nevojat e tregut. Vlen të përmendet në këtë momente të zhvillimit ekonomik të rajonit por edhe më gjerë inovacione e sjella në fushën e teknologjisë së përpunimit dhe prodhimit të produkteve dhe shërbimeve të cilat kërkojnë kualifikime të më tejshme të fuqisë punëtore. Për këtë arsye është e nevojshme hartimi i politikave dhe programeve plotësuese siç janë: trajnimet, praktikat dhe edukimi jo-formal.

Përsa i përket mbështetjes financiare dhe nxitjes së punësimin Bashkinë Përmet do të fokusohet në dy programe kryesore siç janë: Punësimi dhe vetëpunësimi i të rinjve dhe rritja e kapaciteteve të të rinjve për tu integruar më mirë në vendin e punës.

III. OBJEKTIVAT

Objektivat e këtij MasterPlani janë si më poshtë:

1. Të krijojë një kuadër cilësor dhe dinjiteti për punësimin e të rinjve.
2. Të formojë të rinjtë si agjentë me integritet dhe të qëndrueshëm në ndryshimin e situatës së tyre drejtë integritet në tregun e punës nëpërmjet zhvillimit personal dhe profesional dhe kualifikimeve të vazhdueshme.
3. Të ofrojë asistencë të personalizuar në zhvillimin personal të të rinjve dhe mundësi të karrierës në Bashkinë Përmet dhe NJA rurale.
4. Zhvillimi i ekonomisë lokale nëpërmjet promovimit të ekonomisë qarkulluese, biznesit social dhe prurjeve inovative.
5. Rritja e aksesueshmërisë në tregun e punës, programe të aftësisë, mbështetje dhe promovim i nismave për grupet e marginalizuara gratë dhe vajzat.
6. Të sigurojë përmirësimin e situatës së barazisë gjinore në tregun e punës dhe mundësi të barabarta të punësimin dhe zhvillimit profesional.
7. Të rrisë bashkëpunimin midis aktorëve publik dhe privat që operojnë në fushën e punësimin, zhvillimit të karrierës dhe kualifikimeve profesionale.



IV. PARIMET UDHËHEQËSE

Parimet udhëheqëse janë në përputhshmëri me strategjitë lokale, kombëtare dhe ndërkombëtare të punës tek të rinjtë. Ato janë baza mbi të cilat do të hartohen dhe dizajnohen të gjitha veprimet që do të ndërmerren për përmirësimin e gjendjes aktuale të punësimit dhe krijimin e vendeve të reja të punës.


Përshtatja me direktivat Europiane: Më hyrjen në Bashkimin European tregu i punës në Shqipëri do të përballet me një sërë ndryshimesh ndaj është e nevojshme të kuptojmë këto ndryshime duke filluar nga: standarti i tregut të punës, konkurrueshmëria në aftësitë profesionale, kuadri ligjor dhe institucional, dixhitalizimi, lëvizja e lirë e mallrave dhe standarti i produkteve dhe shërbimeve. Për këtë arsye është e rëndësishme të ndërmarrim hapa që në një plan afatgjatë do ti shërbejnë pikërisht këtyre ndryshimeve si dhe minimizimit të rreziqeve dhe kostove të bizneseve shqiptare dhe punonjësve shqiptarë.

Zhvillimi i Qëndrueshëm: Ky parim udhëheq çdo dokument strategjik që hartohet në nivel lokal, kombëtar dhe rajonal. Menaxhimi i burimeve dhe planifikimi i integruar social dhe ekonomik janë shtyllat kryesore ku mbështetet ky parim.

Bashkërendimi: Ky master plan është hartuar duke u bashkërenduar me dokumentat strategjikë në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar më qëllim harmonizimin e punës dhe zhvillimin e aktiviteteve në të mirë të interesave qytetare dhe grupeve të synuara kryesisht të rinjtë.

Punësim Cilësor: për të gjithë: Ky parim synon zhvillimin e individëve duke ofruar asistencë të personalizuar në të gjitha fazat përgatitore drejt tregut të punës si dhe aftësimin dhe trajnimeve të vazhdueshme.

Gjithëpërfshirja dhe Mos-diskriminimi: Ky parim siguron përfshirjen sociale duke u fokusuar më së shumti tek grupet e marginalizuara siç janë gratë dhe vajzat, vajzat që janë viktimat e dhunës, komuniteti rom dhe egjiptian, personat me aftësi të kufizuara dhe të rinjtë në zona rurale dhe emigrantët. Gjithashtu ky parim siguron mundësi të barabarta punësimi dhe kualifikimi të individëve që vijnë nga këto grupe.



Mbështetja e prodhimit vendas dhe ekonomisë lokale: Për të rritur konkurrueshmërinë në tregun europian është e rëndësishme zhvillimi i tregut lokal dhe rajonal të punës, produkteve dhe shërbimeve. Për këtë arsye nxitja e prodhimtarisë dhe ekonomisë lokale do të shoqërohet me krijime të reja të vendeve të punës dhe uljes së papunësisë. Ky parim mbështet të gjitha nismat dhe programet që do të ndërmerren në kuadër të këtij master plani.

Zhvillimi personal dhe profesional: Ky parim synon të vendosë të rinjtë në qendër të gjithë nismave në mënyrë që të rrisë kapacitetet, njohuritë dhe aftësitë e të rinjve për tu përshtatur në vendin e punës. Ky parim do të mbështetet në ciklin e zhvillimit personal dhe profesional duke i bërë të rinjtë agjentë ndryshimi të jetës së tyre.

Bashkëpunim dhe dialog konstruktiv: Për të arritur sa më mirë përmbushjen e objektivave të këtij dokumenti është e rëndësishme bashkëpunimi me të gjithë aktorët e përfshirë si: institucionet lokale, institucionet e arsimit të lartë, institucionet e arsimit të mesëm, institucionet e arsimit profesional, komuniteti i biznesit, akademikë dhe studiues, organizatat rinore, organizatat e biznesit, sindikatat e punëtorëve dhe të rinjtë.

V. ANEKSET

Për të arritur përmbushjen e objektivave të lartë përmendura është e rëndësishme të formulojmë masterplanin e punësimit i cili është i ndarë në gjashtë anekse.

Qëllimi: Prioritizimi i aksioneve që do të ndërmerren në vitet pasardhëse kryesisht për reduktimin e numrit të të rinjve të papunë, përmirësimin e cilësisë së forcës punëtore, fasilitimim drejt vendit të punës dhe zvogëlimin e hendekut gjinor në tregun e punës.



ANEKSI I: ORIENTIMI DREJT TREGUT TË PUNËS

Qëllimi kryesor: Informimi, orientimi profesional, motivimi, këshillimi, diagnostifikimi dhe përcaktimi i profilit të karrierës përfshirë këtu edhe kompetencat, kërkimi për një vend pune dhe ndërmjetësimi në tregun e punës.

Ky aneks përfshin objektivat e mëposhtme:


OBJEKTIV: Këshillimi i karrierës dhe asistencë e personalizuar

Këshillimi i karrierës është një fazë shumë e rëndësishme në jetën e çdo individi e cila i paraprin fazave pasardhëse për kërkimin e vendit të punës. Kjo fazë është e një rëndësie të veçantë pasi nëse hartohet dhe zhvillohet në mënyrën e duhur sjell reduktimin e një sërë kostove duke filluar nga kosto financiare dhe sociale dhe duke sjellë kështu reduktim të dukshëm të numrit të papunësisë. Gjithashtu kjo fazë i shërben individëve të riorganizojnë dhe të mirë menaxhojnë burimet e tyre, njohuritë dhe aftësitë për një kërkim më efikas të mundësive aktuale të punësimit në Bashkinë Korçë por dhe për zhvillimin e mundësive të reja në këtë territor.

Aksioni 1: Formimi i Grupit Këshillimor të Karrierës

Sfida e realizimit të një analize të mirëfilltë të tregut të punës sjell me vete vështirësi për të kuptuar realisht cilat janë nevojat e punëkërkuësve dhe punëmarrësve në tregun e punës në Shqipëri. Kjo është një sfidë në nivel kombëtar dhe lokal i cili ka nevojë për një ndërhyrje sa më të shpejtë.

Formimi i **Grupit Këshillimor të Karrierës** synon më tej formimin e një grupi prej 100 individësh në nivel lokal të kualifikuar specifikisht për orientimin dhe këshillimin e të rinjve. Ky hap përfshin këshillim të personalizuar të individëve sidomos të rinjve duke u bazuar tek interesat, aftësitë e tyre, nevojën e tregut të punës dhe politikat shtetërore. Ajo çka e lidh këtë grup me analizën e tregut të punës është pikërisht analizimi i nevojave specifike të punëkërkuësve dhe fasiliteti i tyre në procesin e zhvillimit personal dhe profesional.



Grupi Këshillimor i Karrierës do të hartojë një **Program Individual Orientimi** i cili do të përfshijë: diagnostifikimin personal, planin personal të zhvillimit dhe planin personal të trajnimit dhe kualifikimit. Në mënyrë që të zhvillohet ky program është e rëndësishme që grupi i këshilluesve të trajnohet paraprakisht dhe të pajiset me informacionin dhe aftësitë e duhura për të përmbushur me sukses fazën e parë. Ky grup duhet të përfshijë ekspertë të fushës, punonjës të burimeve njerëzore, trajnerë dhe mentorë lidhur me zhvillimin personal dhe profesional, përfaqësues nga organizata rinore dhe nga institucionet e përfshira në hartimin e këtij programi si dhe përfaqësues nga institucionet arsimore dhe komuniteti i biznesit. Hartimi i këtij programi do të mbështetet në parimin e gjithëpërfshirjes dhe mos-diskriminimit.


Aksioni 2: Diagnostifikimi dhe Programi Individual i Orientimit Drejt Tregut të Punës

Ky aksion konsiston në evidentimin e prirjeve dhe talenteve të të rinjve si dhe orientimet personale për karriere që ata kanë. Aksioni gjithashtu synon dhe një analizë të punëve më të ofruara nga punëdhënësit në sektore të ndryshme, lokale dhe kombëtare duke bërë të mundur që nëpërmjet përpunimit të këtyre të dhënave të arrijë që të realizojë një program thuajse individual për çdo të ri drejt një orientimi punësimi të sigurt për të ardhmen.

Aksioni 3: Formimi i grupit të Ndërmjetësuesve Rinorë

Aksioni synon realizimin e ëorkshopeve dhe sesioneve informuese në shkolla por edhe më gjerë duke u përcjellë të rinjve gjithë informacionin e nevojshëm mbi profesione më të kërkuara, kualifikimet e nevojshme, zhvillimet e mëtejshme në karriere, orientimet e punësimit, çfarë kërkojnë punëdhënësit në tregun e punës, e ardhmja e tregut të punës, profesione e reja, etj.

Aksioni 4: Këshillim gjithëpërfshirës i të rinjve që vijnë nga zonat rurale, gratë, vajzat, komunitete të ndryshme në Shqipëri si dhe personat me aftësitë të kufizuara.

 Aksioni promovon gjithëpërfshirjen e grupeve të marginalizuara, gratë dhe vajzat dhe personave me aftësi të kufizuara. Gjetja e mënyrave dhe metodologjive më efikase në përcimin e materialeve dhe informacioneve edhe në këto grupe duke bërë të mundur që këshillimi i karrierës të jetë gjithëpërfshirës dhe të arrijë në të gjithë të rinjtë e Bashkisë Përmet.

OBJEKTIVI : Raporti me Aktorët e Tregut të Punës

Një objektiv tjetër i Programit Individual të Orientimit do të jetë dhe krijimi i urave lidhëse midis aktorëve të ndryshëm që janë pjesë aktive e tregut të punës. Këtu përfshihen institucionet arsimore të arsimit të lartë, arsimit të mesëm dhe arsimit profesional, agjensitë shtetërore lidhur me punësimin, komuniteti i biznesit dhe organizatat e shoqërisë civile.

Ky aksion parashikon takime dhe trajnime të përbashkëta të aktorëve të përfshirë kryesisht rreth zhvillimit të qëndrueshëm të tregut të punës dhe një qasjeje më miqësore për të rinjtë në formën e praktikave, punës në distancë apo teorisë dhe praktikës së integruar.

Gjithashtu është e nevojshme të trajnohet komuniteti i biznesit me qasjen europiane dhe aftësinë për të rritur konkurrueshmërinë në tregun europian. Aftësia për tu përshtatur me ndryshimet që do të pësojë ky komunitet me hyrjen në BE mund të krijojë hapësira për punësimin dhe integrimin e të rinjve në strukturat e tyre.


ANEKSI II: EDUKIMI DHE TRAJNIMI

Fusha e edukimit dhe trajnimit është një fushë shumë e gjerë e cila bën bashkë një mori aktorësh të cilët punojnë intensivisht në mbështetjen dhe zhvillimin profesional të të rinjve. Duke qenë se tregu i punës është në lëvizje të vazhdueshme dhe gjithnjë e më shumë dinamik nevoja për trajnime, kualifikime dhe zhvillim të mëtejshëm profesional është gjithmonë prezente. Ky aneks synon të përmbushë objektivat e mëposhtme:

OBJEKTIV: Përmirësimi i Forcës Punëtore të Kompanive dhe Bizneseve

Kapitali njerëzor është një nga asetet më të çmuara të një biznesi dhe është gjithashtu një kapital i cili ka në dorë jetëgjatësinë dhe prezencën e një biznesi në tregun e punës. Me këtë nënkuptojmë se në nivel lidhësi vendimet që drejtuesit marrin për bizneset apo punonjësit e tyre përcaktojnë edhe të ardhmen e një biznesi.





Duke qenë se tregu i punës është i ndryshueshëm i ndikuar më së shumti nga faktori demografik, klimatik, politik dhe teknologjik, nevoja për të përshtatur kapitalin njerëzor me këto ndryshime është thelbësore në qëndrueshmërinë e një biznesi. Me integrimin në BE Shqipëria do të pësojë ndryshime në shumë fusha dhe komuniteti i biznesit është ai që ka një rrezikshmëri të lartë nëse lideret e bizneseve nuk ndërgjegjësohen dhe informohen në lidhje me këto ndryshime. Konkurrenca, standartet e reja, formalitete dhe zhvillimi i aftësive janë disa nga sfidat kryesore.

Aksioni 1: Krijimi i mundësive për kualifikime profesionale dhe zhvillimi i aftësive që lidhen me tregun e punës.

Ky aksion parashikon krijimin e qendrave të trajnimit profesional të bazuara në kapacitetet dhe mundësitë që realisht ofron tregu lokal i punës. Identifikimin e profesioneve dhe punëve që ofrojnë bizneset lokale si dhe krijimi i kurrikulave dhe realizimi i trajnimeve bazuar në këto mundësi që ofron territori i Bashkisë Përmet. Identifikimin e aktorëve mbështetës në realizimin e trajnimeve dhe bashkërendimi i aksioneve ndërmjet tyre.

Aksioni 2: Marrëveshje bashkëpunimi midis shkollave, qendrave të formimit profesional dhe bizneseve

Krijimi i një marrëveshjeje bashkëpunimi midis shkollave, qendrave të formimit profesional dhe institucioneve mbështetëse për të realizuar një planifikim efektiv mbi orientimin e kurseve dhe trajnimeve duke u bazuar totalisht në nevojat për kualifikime dhe kapacitetet e punësimit të bizneseve lokale.

OBJEKTIV: Suport drejt Tranzicionit në Tregun e Punës nëpërmjet zhvillimit të Aftësive dhe Kompetencave

Për të rritur shancet për integrimin në tregun e punës është e nevojshme që fuqia punëtore të njohë shumë mirë si funksionon tregu, si ndryshon dhe se si ata mund të përshtaten më këto ndryshime. Në këtë objektiv fokusi kryesor do të jetë zhvillimi i kompetencave bazë jo vetëm për të përmbushur një CV të pasur por edhe për të rritur konkurrueshmërinë në tregun e punës. Aksionet për të përmbushur këtë objektiv do të hartohen në formën e programeve dhe rekomandimeve të cilat do të lancohen nga Zyra e Punës dhe Zyra përgjegjëse për rininë në Bashkinë Përmet dhe do të përfshijnë:

Aksioni 1: Trajnime mbi kompetencat bazë

Ky aksion parashikon trajnime në përgatitjen e CV-së, kërkimin e vendeve të punës si dhe përgatitje për intervistën me punëdhënësin. Trajnimet do të përgatiten dhe realizohen nga ekspertë dhe menaxherë të burimeve njerëzore të bizneseve ose organizatave të ndryshme.

Aksioni 2: Trajnime mbi kompetencat dixhitale, gjuhët e huaja dhe mundësitë e mobilitetit për studime dhe punësim

Bota dixhitale gjithë e më shumë po bëhet pjesë thelbësore e biznesit dhe jetëve tona. Trajnimet në lidhje me kompetencat bazë kompjuterike janë të domosdoshme për çdo punonjës në të gjitha sektorët e ekonomisë dhe realizimi i tyre mbetet një prioritet thelbësor. Gjithashtu këto zhvillime dixhitale sjellin të nevojshme edhe trajnimin në gjuhët e huaja pasi baza e tyre është në anglisht. Gjithandej sot nëpër rrjetet sociale dhe ëeb faqe të ndryshme publikohen kurse dhe trajnime studimi për formim në profesione të ndryshme por edhe për zhvillime të mëtejshme të profesionit. Për këtë motiv është e nevojshme realizimi i trajnimeve për gjurmimin e këtyre trajnimeve dhe përgatitjen e aplikimeve për pjesëmarrje dhe rrjedhimisht kjo dhe do të sillte edhe një përgatitje për mobilitetin e të rinjve për tu përshtatur dhe marrë pjesë në këto trajnime.

Aksioni 3: Trajnime në bujqësi, blegori dhe agroturizëm si potencial për zhvillimin ekonomik në nivel lokal

Bujqësia, blegtoria dhe agroturizmi janë sektorët kyç të gjenerimit të të ardhurave dhe krijimit të vendeve të punës kryesisht gjatë 5-vjeçarit të fundit në Bashkinë Përmet. Janë të nevojshme dhe prioritare, gjithnjë e më shumë dhe në vazhdimësi programe trajnuese në përpunimin e produkteve bujqësore, respektimin e kushteve hidro-sanitare, ruajtjen dhe promovimin e kulturave autoktone në bujqësi, rritja e nivelit të shërbimeve në agroturizëm, prezantimin e masafe dhe standarteve europiane mbi këta sektorë të ekonomisë.

Aksioni 4: Programe bursash për studentët në vështirësi ekonomike që dëshirojnë të vazhdojnë studimet e larta

Ky aksion konsiston në ndërtimin e programeve për bursa për një mbështetje sa më të gjerë të studentëve në vështirësi ekonomike të cilët duan të vazhdojnë studimet e larta. Programet synojnë që përveç mbështetjes aktuale me bursa të Bashkisë Përmet të krijojnë rrjete donatorësh private, të kërkojë donatorë private si dhe të publikojë dhe promovojë mundësi të ndryshme bursash studimi nga donatorë dhe organizata të ndryshme të cilat çdo vit nxjerrin shpalljet e tyre për mbështetje me bursa studimesh.

Aksioni 5: Trajnime për inovacionin në edukim

Aksioni i referohet stafëve dhe përgjegjësve të institucioneve që realizojnë kurse formimi profesional dhe edukim profesional. Ky aksion synon të trajnojë stafet e këtyre institucioneve mbi inovacione në fushën e edukimit dhe formimit profesional duke sjellë praktikën më të kohës në edukim dhe shembujt më inovativ nga rajoni dhe më gjerë.

Aksioni 6: Trajnime për stafet e bizneseve apo institucioneve për asistimin e grupeve të marginalizuara në tregun e punës dhe gjithëpërfshirjen

Aksioni orientohet drejt trajnimit të stafëve të bizneseve dhe institucioneve lokale për të rritur ndërgjegjësimin dhe kapacitetet e tyre në mbështetje të grupeve të marginalizuara si në kërkimin e vendeve të punës por edhe në normat dhe rregullat e sjelljes në vendin e punës.

ANEKSI III: MUNDËSITË E PUNËSIMIT

Ky aneks i dedikohet kryesisht grupeve të marginalizuara në mënyrë që të nxisë punëdhënësit të punësojnë, krijojnë hapësira dhe të mbajnë në punë individë të cilët kanë vështirësi në ndërrimin e punës dhe gjenden në situatë ku kanë nevojë për suport ekonomik. Këtu përfshihen kryesisht personat më aftësi të kufizuar, gratë viktime të dhunës, emigrantët, viktime të terrorizmit apo të rinjtë që kanë probleme në familje dhe strehohen në qendra sociale.

Të rinjtë kryesisht janë më të pasigurtë pasi mund të bien më lehtësisht pre e abuzimeve dhe të përjashtohen nga aksesueshmëria në vendin e punës.



Ky aneks synon përmbushjen e objektivave si më poshtë:

OBJEKTIV: Rritja e Aksesueshmërisë në Tregun e Punës

Aksioni 1: Krijimi i një networku midis shkollave-institucioneve-biznesit

Aksioni parashikon krijimin e një networku midis shkollave -institucioneve-bizneseve në evidentimin e vendeve të lira të punës, kualifikimet e nevojshme të fuqisë punëtore të kërkuar si dhe kualifikimet e mëtejshme për rritje profesionale të nevojshme të fuqisë punëtore.

Aksioni 2: Programi mbështetës për grupet vulnerabël

Grupet vulnerable janë pjesa më në nevojë e shoqërisë pasi aksesit që këto grupe kanë në informacione por edhe mundësitë për kualifikime të tyre janë të pakëta. Nëpërmejt këtij aksioni synohet të realizohet përcjellja sa më shumë e informacionit dhe rritja e aksesit të tyre në programet e formimit profesional dhe punësimit.

Aksioni 3: Projekte Pilot mbështetur në ekonominë qarkulluese

Ekonomia qarkulluese është një sistem ekonomik që synon minimizimin e mbetjeve nëpërmjet përdorimit të vazhdueshëm të burimeve. Ky aksion do të promovojë dhe mbështesë një ekonomi qarkulluese ku mbetjet minimizohen dhe burimet përdoren më shumë ekonomikisht, në mënyrë afatgjatë, nëpërmjet ripërdorimit, riparimit dhe riciklimit të tyre. do të synohet krijimi i fondeve mbështetëse dhe asistencë teknike e iniciativave dhe projekteve pilot të ndërmarra.

Aksioni 4: Programi për suportin dhe promovimin e talenteve

Aksioni synon përfshirjen, angazhimin dhe nxitjen e të rinjve për të marrë pjesë në aktivitete krijuese dhe edukuese, promovimin e punimeve dhe realizimeve nga të rinjtë si dhe vlerësimin e të rinjve për rezultatet e arritura. Aksioni gjithashtu synon gjetjen e rrugëve të bashkëpunimit dhe mbështetjes, si në vlera monetare por edhe institucionale se të rinjve të talentuar për të zhvilluar më tej idetë dhe kreativitetin e tyre.



ANEKSI IV: AKSES I BARABARTË NË PUNËSIM

Bazuar në parimin e gjithëpërfshirjes, ky aneks synon krijimin e mundësive të barabarta për individët dhe sidomos të rinjtë që vijnë nga shtresat e varfra, komuniteti rom, aftësia e kufizuar, zonat rurale dhe gratë dhe vajzat si dhe viktimat e dhunës në familje.

OBJEKTIV: Barazia Gjinore dhe Gjithëpërfshirja në Tregun e Punës

Aksioni 1: Krijimi i bashkëpunimit me aktorët që punojnë me barazinë gjinore

Aksioni synon evidentimin e të gjithë aktorëve të cilët kanë si objektiv të punës së tyre barazinë gjinore. Realizimin e takimeve dhe dokumentave ndihmëse të cilat do të bashkërendojnë veprimet midis këtyre aktorëve në funksion të rritjes të efektshmërisë të aktiviteteve dhe projekteve që ata ndërmarrin.

Aksioni 2: Programi i start-upeve për gratë dhe vajzat në teknologji dhe inovacion

Start-upet gjithmonë krijojnë mundësi të reja në ekonomi dhe në mënyrën e jetesës si dhe gëjëtetëse për gratë dhe vajzat në teknologji dhe inovacion do të synojë krijimin e vendeve të reja të punës, risi në tregun lokal të punës si dhe zhvillim të ekonomisë lokale.

Aksioni 3: Programi i mbështetjes së grave dhe vajzave në zonat rurale

Gratë dhe vajzat në zonat rurale janë pjesa më vulnerabël dhe më pak e mbështetur në komunitetin tonë. Ky aksion synon krijimin e lehtësirave në aksesin e informacionit dhe të burimeve financiare nga kjo pjesë e komunitetit për ti hapur rrugë ideve dhe projekteve të propozuara nga to për zhvillimin e ekonomisë rurale dhe rritjen e të ardhurave familjare. Do të synohen ngritja e skemave mbështetëse për realizimin e aktiviteteve në fushën e përpunimit të produkteve agroushqimore, produkteve blektorale, bimëve medicinale, agroturizmit dhe artizanatit.



ANEKSI V : SIPËRMARRJA

Ky aksion lidhet ngushtë me aktivitete që promovojnë sipërmarrjen, vetë-punësimin dhe bizneset sociale me qëllim zhvillimin e ekonomisë lokale në qendër dhe zonat rurale të Përmetit. Programet do të lidhen kryesisht me dhënien e granteve dhe krijimit të një grupi donatorësh që të sigurojnë qëndrueshmërinë e fondeve në fushën e sipërmarrjes.

OBJEKTIV: Promovimi i Sipërmarrjes

Aksioni 1: Krijimi i një networkut të donatorëve të huaj/biznese lokale

Aksioni parashikon identifikimin e donatorëve të cilët kanë kontribuar në të kaluarën dhe aktualisht janë mbështetës të iniciativave dhe projekteve rinore. Do të realizohen takime me këta donatorë dhe do të synohet dalja me një deklaratë të përbashkët nga donatorët për krijimin e fondeve të mbështetjes të iniciativave të ndryshme rinore sipas natyrës dhe sektorëve të interesit.

Aksioni 2: Promovimi i biznesit social/model suksesi

Në shumërajone dhe lokalitete biznesi social ka rezultuar me impakt të lartë në punësimin rinor dhe ofrimin e mundësive për të rinjtë. Kjo pasi biznesi social orientohet drejt të mirës të përgjithshme sociale dhe jo drejt maksimizimit të fitimit. Ky aksion synon krijimin e mundësive dhe urave bashkëpunuese midis institucioneve, OJF-ve të ndryshme dhe donatorëve të ndyshëm në mbështetje dhe zhvillimin e bizneseve sociale duke krijuar kushte fasilizuese.

Aksioni 3: Inkubatori i biznesit

Aneksi synon të mbështesë ndërmarrësit e rinj në aftësim përmes trajnimeve për zhvillim të biznesit, mbështetje teknike dhe administrative, këshillim për menaxhim dhe zhvillim të biznesit, çështje ligjore, financiare, si dhe qasja në financa. Inkubatori i biznesit do të mbështesë dhe përshpejtojë procesin e zhvillimit të suksesshëm të sipërmarrjeve të reja duke i ndihmuar ndërmarrësit e rinj me burime dhe shërbime të ndyshme.

Aksioni 4: Trajnime dhe Certifikime Profesionale

Ky aksion mbështetet në trajnime dhe certifikime në fushën e sipërmarrjes dhe menaxhimit në biznes. Realizimi i trajnimeve të tilla si menaxhimi financiar, raportet e të ardhurave shpenzime, sistemi i taksave dhe tatimeve, planet e biznesit, planet strategjike zhvillimore në biznes do të pajisin të rinjtë dhe pjeësmarrësit me njohuritë bazë për ecurinë e mëtjeshme të sipërmarrjeve të tyre por edhe do të shërbejë si kualifikim për pozicionet e punës që ata mund të aplikojnë në të ardhmen.

OBJEKTIV: Promovimi i Bizneseve Lokale dhe Produkteve Ushqimore Tradicionale.

Për të rritur konkurrueshmërinë në tregun kombëtar dhe rajonal është e rëndësishme zhvillimi i brendshëm i ekonomisë në mënyrë të qëndrueshme. Për ti shërbyer kësaj objekteve i duhet dhënë një shtysë bizneseve lokale sidomos atyre në zonat rurale me fokus në: turizëm, bujqësi, blegtori, artizatat dhe kulinari.

Aksioni: Zhvillimi i Panairit të Biznesit Lokal dhe Njëmbështetja me Pjesëmarrje në Panaire të Ndryshme Biznesi

Aksioni synon krijimin e panairit lokal të biznesit me një mbledhje dhe ekspozim të punëdhënësve, bizneseve, vendeve të reja të punës, arritjeve në biznes, planeve dhe projekteve për të ardhmen nga biznese të ndryshme, donatorë që mbështesin idetë e reja, prezantime idesh biznesi, institucione dhe organizata të cilat kryejnë veprimtarinë e tyre në mbështetje të zhvillimit të start-up dhe formimit të kapaciteteve, etj. Gjithashtu ky aksion parashikon dhe pjesëmarrjen në panaire të ndryshme rajonale dhe kombëtare për të krijuar ura bashkëpunimi, shkëmbim eksperiencash dhe rritje kapacitetesh.



ANEKSI VI: PËRMIRËSIMI I KUADRIT INSTITUCIONAL

Në nivel lokal është e rëndësishme që institucionet të luajnë një rol rregullator dhe fasilitues midis aktorëve.

Aksioni 1: Krijimi i një platforme online të punësimit

Aktualisht rolin e shpallejes së vendeve të lira të punës dhe punësimin e të rinjve dhe individëve të tjerë e luan Zyra e Punësimit. Ky aksion parashikon krijimin e një platforme online të punësimit ku të gjitha institucionet, bizneset apo edhe organizmat e ndryshme të publikojnë thirrjet e tyre për vende vakante pune. Platforma do të jetë e lirë dhe e aksesueshme nga të gjithë.

Aksioni 2: Fasilitimi në shkëmbimin e informacionit

Aksioni konsiston në fasilitimin nga ana e stafeve të Zyrës së Punës dhe Zyrës përgjegjëse në bashki për punësim duke ndjekur procesin e punësimit dhe rekrutimit të të rinjve nga ana e punëdhënësve me informacionet e nevojshme për vendin e punës për të cilën kandidojnë. Fasilitimi gjithashtu është i nevojshëm edhe nga ana e institucioneve të tjera në plotësim dokumentacioni të nevojshëm për plotësimin e dosjes së aplikimit për punë.

Aksioni 3: Të nxisin projektet pilot me donator nga bizneset lokale

Sipërmarrësit dhe bizneset janë një element i rëndësishëm në shoqëri. Janë ata gjithmonë pionerë të ndryshimeve sociale dhe risive në mënyrën tonë të jetesës. Ajo që vlen për tu përmendur është që biznesi dhe sipërmarrësit në Përmet janë gjithmonë në mbështetje dhe në kontribut të nismave dhe aktiviteteve lokale të ndërmarra nga të rinjtë. Ky aksion konsiston në realizimin e konkurseve me ide biznesi më të mira të propozuara nga të rinjtë dhe mbështetja e fituesve me grande financiare dhe suport logjistik dhe menaxherial për zhvillimin e ideve që ata propozojnë.